

**SYLLABUSI i Lëndës: Kontabiliteti Financiar i Ndërmarrjeve të Mesme dhe Vogla**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti Ekonomik
<b>Titulli i lëndës:</b>	Kontabiliteti Financiar i Ndërmarrjeve të Mesme dhe Vogla
<b>Niveli:</b>	Master
<b>Statusi lëndës:</b>	Obligativee
<b>Viti i studimeve:</b>	Tretë (III-të)
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+2
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	
<b>Koha / lokacioni:</b>	
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Prof.dr.asc. Sejdi Rexhepi
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<a href="mailto:Sejdi.rexhepi@uni-pr.edu">Sejdi.rexhepi@uni-pr.edu</a> 045/ 308 809
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Lënda Kontabiliteti Financiar i Ndërmarrjeve të mesme dhe të Vogla ka të bëjë me evidencën dhe raportimin kontabël. Regullativa ligjore sikurse edhe standardet ndërkombëtare të evidencës dhe raportimit kontabël do të shpjegohen. Librat e kontabilitetit të thjesht sikurse edhe ato të kontabilitetit financiar.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Që studentëve të ju ofrohen njohuri mjaftë të kompletuara lidhur me evidencën dhe raportimin kontabël të bizneseve të mesme dhe të vogla.</li> <li>2. Që studentët të fitojnë njohuri dhe të aftësohen për aplikimin praktikë të kornizës teorike dhe praktike të evidencës dhe raportimit kontabël për bizneset e mesme dhe të vogla.</li> </ol>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të kuptojnë se cilat janë ndërmarrjeve e mesme dhe të vogla sipas ligjeve në fuqi dhe cilat janë obligimet e tyre për evidencën dhe raportimin kontabël.</li> <li>2. T'i njohin rregullativen ligjore dhe standardet ndërkombëtare për evidencën dhe raportimin financiar të ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla.</li> </ol>

	<p>3. Të jenë në gjendje që njohuritë e fituara ti përdorin për të analizuar, kuptuar dhe aplikuar në praktikë lidhur me evidencën dhe raportimin kontabël- financiar, për ndërmarrjet e mesme dhe të vogëla.</p> <p>4. Që aftësitë dhe dituritë e fituara të mund ti përdorin në mënyrë kreative për të njohur, kuptuar, krahasuar, analizuar dhe për të zhvilluar mendimin profesional dhe kritik për evidencën dhe raportimin kontabël për ndërmarrjet e mesme dhe të vogëla.</p>
--	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollofiume, seminare	1	15	15
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	2	5
Projektet, prezantimet ,etj.			
<b>Totali</b>			<b>180</b>

**Metodologjia e mësimdhënies:**

*a). Qasja është e bazuar në pjesëmarrjen aktive të studentëve*

1. Mësimdhënësi shpjegon objektivat e mësimit studentëve përmes ligjëratave,
2. Përmes tabelës, projektorit dhe formave tjera vizuale prezantohen teoritë dhe konceptet kryesore
3. Mësimi i kombinuar interaktiv do të

	<p>përdoret</p> <p>4. Konkludime të përbashkëta do të nxirren përmes diskutimit të pyetjeve dhe çështjeve të ngritura.</p> <p><b>b). Aktivitetet Grupore</b></p> <p>1. Tryeza pune, diskutime grupore, prezantime grupore</p> <p><b>c). Aktivitetet tjera</b></p> <p>1. Kërkime të pavarura nga studentët</p> <p>2. Prezantimi i rezultateve</p> <p>3. Seminare</p> <p><b>d). Mjetet e punës:</b>  Tekste mësimore, artikuj, harta, tabela, projektori, fletat e punës, materiale të përgatitura nga mësimmshënësi, etj.</p>														
<p><b>Metodat e vlerësimit:</b></p>	<p>Vlerësimi i studentëve do të bëhet në bazë të disa kriterëve bazë. Studentët do të kenë dy teste provuese me shkrim gjatë mbajtjes së ligjëratave dhe një test (provimin) përfundimtar.</p> <p>Vlerësimi dhe notimi do të bëhet duke marr parasysh suksesin e treguar në teste dhe provimin final si dhe angazhimin e përgjithshëm.</p> <p>Çdo student ka për obligim që të përgatisë dy detyra të shtëpisë si dhe një punim seminarik të cilat së bashku janë pjesë e vlerësimit të përgjithshëm nga kjo lëndë. Tema e detyrave të shtëpisë si dhe e seminarit duhet të caktohet në bashkëpunim me mësimmshënësin e në pajtim me planin mësimorë nga lënda.</p> <p>Nota do të ndërtohet duke marrë për bazë këto kriterë:</p> <table data-bbox="716 1514 1268 1766"> <tr> <td>Detyra e parë:</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Detyra e dytë:</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Vlerësimi i parë:</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>Vlerësimi i dytë:</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>Provimi final</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>Punimi Seminarik</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td><b>Total</b></td> <td><b>100%</b></td> </tr> </table>	Detyra e parë:	10%	Detyra e dytë:	10%	Vlerësimi i parë:	20%	Vlerësimi i dytë:	20%	Provimi final	20%	Punimi Seminarik	20%	<b>Total</b>	<b>100%</b>
Detyra e parë:	10%														
Detyra e dytë:	10%														
Vlerësimi i parë:	20%														
Vlerësimi i dytë:	20%														
Provimi final	20%														
Punimi Seminarik	20%														
<b>Total</b>	<b>100%</b>														
<p><b>Literatura</b></p>															

<b>Literatura bazë:</b>	<p><b>1. Ligjëratat e mësimdhënësit</b></p> <p><b>2. Literatura tjetër plotësuese</b></p> <p><b>a). Në gjuhën shqipe:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kontabilitetit Financiar Informacion për vendime, Ingram Ailbright, Baldvin. Përkthyer në shqip, Prishtinë, 2004.</li> <li>2. Kontabilitetit Financiar, Skender Ahmeti, Prishtinë.</li> <li>3. Kontabiliteti Financiar, Sotiraq Dharmo, Tiranë.</li> <li>4. Kontabilitetit i Tatimeve, SHKCK, Prishtinë.</li> <li>5.</li> </ol>
<b>Literatura shtesë:</b>	<p><b>b). Në gjuhën Angleze</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. IFRS for SMEs International Financial Reporting Standard (IFRS for Small and Medium-sized Entities (SMEs))</li> <li>2. Book-keeping &amp; accounting for the small business, Peter Taylor, 2003.</li> <li>3. Fundamental Accounting Principles, Eild, Larson, Chiappetta, McGraë Hill, Irëin, 2007.</li> </ol>
<b>Plani i dizajnuar i mësim:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjëratat që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	<p><b>Prezantimi hyrës i lëndës.</b>  Njoftimi me student, prezantimi i mësimdhënësit, prezantime hyrëse lidhur me lëndën dhe programin mësimor, njoftimi lidhur me metodologjinë e punës, vlerësimin dhe notimin.</p>
<i>Java e dytë:</i>	<p><b>Format juridike të regjistrimit të bizneseve</b>  Ligji për shoqëritë tregtare  Format e organizimit të bizneseve  Obligimet tatimore të biznesit sipas ligjit për ATK-në dhe procedurat  Llojet e tatimeve në Kosovë.</p>
<i>Java e tretë:</i>	<p><b>Librat e kontabilitetit të bizneseve të vogla dhe të mesme</b>  Mbajtja e librave dhe regjistrimeve të kontabilitetit  Libri i blerjeve  Libri i shitjeve  Libri i llogarisë bankare</p>

	Menaxhimi faturave dhe dokumentacionit tjetër kontabël
<b>Java e katërt:</b>	<b>Kontabiliteti i thjeshtë (njëfishtë)</b> Evidencat jo të plota të kontabilitetit. Konstruktimi i pasqyrave financiare nga dokumentacioni kontabël pa regjistrime të rregullta. Kalkulimi i fitimit afarsit ssi dhe gjendjes financiare.
<b>Java e pestë:</b>	<b>Regjistrimi i transaksioneve të një biznesi në rritje</b> Përdorimi i librit të parave të gatshme Regjistrimi i shitjeve Regjistrimi i blerjeve Aplikimi i kontabilitetit rrjedhës (akruar) Regjistrimet e transaksioneve tjera
<b>Java e gjashtë:</b>	<b>Vlerësimi i pare</b>
<b>Java e shtatë:</b>	<b>Kontabilitetit i Tatimit në Vlerën e Shtuar (TVSH)</b> Aspektet teorike lidhur me tatimi në vlerën e shtuar Ligji për tatimin në vlerën e shtuar Si TVSH ndikon biznesin e vogël dhe të mesëm Regjistrimi në kontabilitet i transaksioneve me TVSH
<b>Java e tetë:</b>	<b>Kontabiliteti i pagave</b> Kontabiliteti i pagave Llogaritja e pagave dhe mëditjeve Kalkulimi i obligimeve dhe ndalesave dhe pagës neto Kalkulimi tërheqjeve të pronarit dhe të drejtorëve Ligji për të ardhurat personale Kontabiliteti dhe plotësimi i deklaratës së tatimit në të ardhura personale
<b>Java e nëntë:</b>	<b>Kontabiliteti i dyfishtë</b> Përparësitë dhe të metat e kontabilitetit të dyfishtë Librat e Kontabilitetit të dyfishtë Regjistrimet në kontabilitetit të dyfishtë Gjetja e gabimeve, përmirësimi i gabimeve Libër mbajtja dhe kontabilitetit i bizneseve të vogla dhe të mesme
<b>Java e dhjetë:</b>	<b>Obligimet tatimore te bizneseve</b>

	Kontabiliteti i Bizneseve me një pronar Kontabiliteti i Shoqërive kolektive dhe ortakëritë e kufizuara kontabiliteti i Kompanive aksionare
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<b>Vlerësimi i dytë</b>
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<b>Menaxhimi i informatave të kontabilitetit</b> Përcjellja e pozicionit të parave të gatshme Menaxhimi i buxhetit të biznesit Analiza vertikale dhe horizontale e pasqyrave financiare Analiza e likuiditetit
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<b>Kontabiliteti i huas (kredive), këstet dhe qiraja afatgjate (lizingu)</b> Trajtimi kontabël i huas Trajtimi kontabël i kthimit dhe kësteve të huas Regjistrimi i disburësimit (dhënies) së një kredie Përlllogaritja dhe regjistrimi i këstit dhe interesit të huas Regjistrimi i provizioneve për humbje në kredi Regjistrimi kontabël i kredive në vonesë kthimi Qiraja afatgjate Regjistrimi në kontabilitet i qirasë afatgjate
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	<b>Kontabiliteti i tatimit në të ardhura të korporatave</b> Ligji për tatimin në të ardhura të korporatave Përlllogaritja e tatimit në të ardhura të korporata Korrigjimi i pasqyrës së të ardhurave për nevoja të tatimit Plotësimi i deklaratës së tatimit në të ardhura Regjistrimi në kontabilitet i tatimit në të ardhura
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<b>Përgatitja e llogarisë vjetore</b> Bilanci i gjendjes Bilanci i të ardhurave Bilanci i rrjedhave monetare Metoda direkte dhe indirekte e llogaritjes së rrjedhave monetare Pasqyra e ekutietit (kapitalit të pronarit)
	<b>Vlerësimi përfundimtar</b>

### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studentët me qëllim të arritjes së suksesit të lartë në studime duhet që:

1. Të vijojnë rregullisht ligjëratat dhe ushtrimet e parapara
2. Të marrin pjesë në mënyrë aktive në ligjëratat përmes pyetjeve, debateve dhe formave tjera të veprimit interaktiv
3. Në marrëveshje me mësuesin të punojnë një punim seminarik (detyrë shtëpie) prej 7-10 faqe
4. Të marrin pjesë në testet e ndërmjetme si dhe në testin përfundimtar

Gjatë kohës së mbajtjes së ligjëratave, ushtrimeve, testeve apo provimeve kanë për obligim që t'i nënshtrohen kodit të mirësjelljes (mbajtja e qetësisë në mësim, hyrja me kohë në sallë, lëshimi i sallës me pëlqimin e mësuesit, etj).